

VENDIM
Nr. 95, datë 16.7.2012

PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË
SHOQËRISË “POWER ELEKTRIK SLLABINJË” SHPK ME NR. 93, SERIA PV10K, LËSHUAR ME
VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S
NR. 10, DATË 8.2.2010

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 13, 14 pika 2, 15 pika 1, pika 2 germa “b”, pika 3, pika 4, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.7.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Power Elektrik Sllabinje” sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr. 93, seria PV10K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 10, datë 8.2.2010 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Power Elektrik Sllabinje” sh.p.k. plotëson kërkesat e rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Neni 15, pika 4, germa “a”:

Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (është plotësuar tërësisht).

Neni 15, pika 4, germa “b”:

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Modifikimin e licencës së shoqërisë “Power Elektrik Sllabinje” me nr. 93, seri PV10K, për prodhimin e energjisë elektrike nga hec “Sllabinje” me fuqi 9.3 MW, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 10, datë 8.2.2010.

2. Fuqia e instaluar e hec “Sllabinje” nga 9.3 MW të bëhet 13.8 MW.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani